

V E N D I M
Nr. 140, datë 25.3.1999

**PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN E KËSHILLIT TË MINISTRAVE NR.505, DATË
24.10.1994 "PËR TRAJTIMIN ME USHQIM TË KUADROVE USHTARAKË AKTIVË, QË
SHËRBEJNË NË STRUKTURAT E USHTRISË."**

Në mbështetje të nenit 100, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, dhe të ligjit nr.8439, datë 29.12.1998 "Për buxhetin e shtetit të vitit 1999", me propozimin e Ministrisë së Mbrojtjes, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Në vendimin e Këshillit të Ministrave nr.505, datë 24.10.1994 "Për trajtimin me ushqim të kuadrove ushtarakë, aktivë, që shërbejnë në strukturat e ushtrisë ", pika 3 ndryshohet si vijon ":

"3. Trajtimi sipas pikave 1 dhe 2 të këtij vendimi, të bëhet vetëm për ditët efektive të punës së çdo ushtaraku, si dhe për ditët e shtuna, të diela, festa zyrtare, për ushtarakët, që vazhdojnë studimet në Akademinë e Mbrojtjes, apo që ndjekin kurse të tjera kualifikimi e që nuk kanë mundësi të shkojnë pranë familjes në këto ditë, dhe, në çdo rast, vetëm për kuadrot ushtarakë, efektivë të sistemit të Ministrisë së Mbrojtjes."

2. Efekti ekonomik të përballohet nga buxheti vjetor, i miratuar për vitin 1999 për Ministrinë e Mbrojtjes.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Pandeli Majko